



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.106 dt.24.07.1998

PER
“SHITJE TROJESH SHTETERORE TE ZENA”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e dt.24.07.1998, në bazë të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës “Për shitje trojesh shtetërore të zëna”, mbështetur në ligjin Nr.7980, “Për shitblerjen e trojeve”, dt.27.07.1995, ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, ligjit Nr.7693, dt.06.04.1993 “Për urbanistikën”, VKM Nr.312, dt.30.06.1994 “Për çmimin e shitjes trojeve” shkresës së K.M. Nr.4079, Prot. Dt.24.12.1997 që le në fuqi VKM Nr.312, VKB Nr.165, dt.29.09.1997 “Për miratimin e rregullores për shitjen e trojeve personave fizikë e juridikë vendas apo të huaj për rastet kur është ndërtuar mbi to”

VENDOSI

1. Të miratojë kërkesën e Z.Leka Bunga për blerjen e truallit të zënë prej 225m² në rrugën “Pjetër Bogdani”.
2. Të miratojë pjesërisht kërkesën e Z.Shendi Hajrullai për blerjen e truallit të zënë dhe sipërfaqe funksionale prej 300m² në rrugën e “Durrësit” Laprakë.
3. Të miratojë kërkesën e Znj.Luljeta Kasemi për blerjen e truallit të zënë prej 70m² në rrugën “Sami Frashëri”.

4. Të mos miratojë kërkesën e Z.Petrit Kumi meqënëse nuk i plotëson kërkesat ligjore për blerjen e truallit prej 60m² në rrugën “Brigada VIII”.
5. Të mos miratojë kërkesën e Z.K.Jakupi dhe Q.Jakupi për blerjen e truallit në rrugën “M.Gjollesha” deri në konfirmimin e dokumentacionit teknik në arshivën e Bashkisë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI